

**PORTOFOL MIKS**

mundëson një balancë midis riskut dhe përfitimit

DIVERSIFIKIM I INVESTIMEVE

për tregjet në monedhë të huaja

TREGJE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrje në tregjet e huaja të aksioneve/obligacioneve

Raport Mujor Janar 2023

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 2,127,458
Cmimi i kuotës	92.7270
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Kthimi vjetor nga investimi ne 31 Janar 2023	-8.90%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.59% per vitin 2022 ne 31.12.2022
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetë butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë


Përfitimet tipike më të larta



Profili i parashikuar i rrezikut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të rrezikut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit




Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet. Pjesa e aksioneve (32.4%) është e investuar kryesisht në tregje të zhvilluara: SHBA 19.2%; Zona Euro 8.5%, Britani e Madhe 2.5% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është 3.7%.

Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri pozitive gjatë muajit Janar. Çmimi i kuotës është rritur me **1.40%** krahasuar me muajin Dhjetor. Tregu i obligacioneve performoi mirë gjatë muajit, si rrjedhojë e mundësisë që Bankat Qendrore të ngadalësojnë ritmin e rritjes së normave. Tregu i aksioneve ndoqi të njëjtën rrugë dhe Janari ishte muaji me performancën më të mirë që prej një kohe të gjatë. Të gjitha sa më sipër kanë shkaktuar një rivlerësim pozitiv të portofolit të investimeve të fondit Mks, i cili rezultoi me fitim gjatë këtij muaji.

Kthimi vjetor neto i fondit Mix ishte -8.90% më 31 Janar 2023.



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe te gjithë fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfiturar nje

kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen qe te ruajne investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qendrimit ne fond te nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse ne kete menyre nuk do te rrezikojne te dalin nga fondi ne momentin e gabuar per investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Janar

Inflacioni i Eurozonës u ul në nivelin 8.5% në Janar nga 9.2% në Dhjetor, duke dhënë prova se presionet e çmimeve kanë arritur kulmin. Në SHBA, norma vjetore e inflacionit ishte 6.5% (shifra më e ulët për vitin përmbyllës 2022), duke ndjekur trendin rënës që filloi në Korrik.

Zyrtarët e Rezervës Federale janë në rrugën e duhur për të konsideruar stopimin e rritjes së normave të interesit pas takimit të tyre të Marsit, nëse shfaqen më shumë prova të rënies së inflacionit. Politikëbërësit priten të rrisin normat me një çerek përqindjeje në takimin e tyre të Shkurtit, duke arritur intervalin 4.5% - 4.75 %, një ngadalësim nga rritja prej 50 pikësh bazë në Dhjetor.

Për sa i përket BQE-së, priten dy rritje të tjera prej 50 pikësh në mbledhjet e ardhshme për të siguruar që inflacioni të kthehet në nivelin e synuar. Një ulje e normës së interesit është e mundur si për BQE-në, ashtu edhe për Rezervën Federale, përpara fundit të vitit, në varësi të zhvillimeve të normës së inflacionit.

Obligacionet kanë performuar pozitivisht gjatë Janarit, mbështetur nga mundësia që Bankat Qendrore të

ngadalësojnë ritmin e rritjes së normave. Tregjet duket se e kanë reflektuar tashmë rritjen e ardhshme të normave, duke hapur rrugën për më shumë rënie të yield-eve. Për më tepër, faktorët themelorë për obligacionet e korporatave të cilësisë së lartë, veçanërisht të emtuara në tregjet e sterlinës dhe euros, janë të favorshëm.

Janari ishte një nga muajt më të mirë që prej një kohe të gjatë, edhe për tregun e aksioneve. Indekset kryesore u rritën me 6-10% dhe sektorë si: shërbimet e konsumit ciklike dhe telekomunikacioni ishin ndër performuesit më të mirë. Ndërsa aksionet mbeten në rënie krahasuar me tremujorin e shkuar, ato kanë tejkaluar pritshmëritë, duke e nisur vitin majftueshëm pozitivisht.

Nga ana tjetër, të dhënat paraprake të Eurostat treguan se Eurozona u rrit me 0.1% në tremujorin e katërt, ndërsa ekonomistët kishin parashikuar një tkurrje prej 0.1% për të njëjtën periudhë. Megjithatë, ekonomia më e madhe europiane, Gjermania, u tkurr me 0.2% në tremujorin e fundit të 2022.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dh eforcashitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar t ëkuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrvetë Raiffeisen Invest sha., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank nëShqipëri.